

SEANCAT E DISA PREJ SHOQATAVE TË PENSIONISTËVE

EDHE GJATË PANDEMISË, PENSIONISTËT JANË AKTIV

Senaca dhe aktivitete nën masa mbrojtëse u mbajtën edhe në shoqatat: Qendër, Makedonski brod, Vallandovë, Prilep, Dellçevë

Shkup, 19 gusht - Këshilli ekzekutiv i Kuvendit të SHP Çair, më 12 gusht të këtij viti në klubin e Shtëpisë së pensionistëve "Lika Çopova" në Fushë Topane, mbajti seancën e saj të katërt të rregullt. Seanca u mbajt në kushte të respektimit të masave mbrojtëse nga Covid-19. Të gjithë të pranishmit fillimisht i dezinfektuan duart dhe gjatë tërë kohës ishin me maska në fytyrë. Në fillim, kryetari i Këshillit ekzekutiv, Mentor Qoku, i përshëndeti të pranishmit dhe foli për punën e Shoqatës në kushtet e Koronavirusit, duke e theksuar që të gjitha komisionet dhe Aktivi i pensionistëve takimet e tyre i mbajnë sipas nevojës. Në pajtim me rekomandimet e LSHPM, Klubi punon në taracë, në të cilën janë të siguruara kushtet adekuate për punë. Si përfundim, u soll të vazhdohet me punë në shoqatë, ashtu siç është punuar deri më tani në kushte të



veçanta, në mënyrë të vazhdueshme. Në seancë është miratuar vendimi për angazhimin e një personi profesional, i cili do të instalojë programet dhe aplikimet e duhura themelore të kompjuterëve të shoqatës. Në lidhje me azhurnimin e gjendjes së numrit të anëtarësisë në shoqatë, u soll përfundim që të vazhdohet me vendosjen e rrugëve kufitare ndaj shoqatave fqinje, ndërsa në të, të përfshihen sekretarët dhe kryetarët e degëve. Anëtarët e Këshillit ekzekutiv, në seancë sollën vendim të ndahet ndihmë e pakthyeshme e të hollave të një pensioniste, e cila është e sëmurë rëndë, anëtare e shoqatës. Edhe Këshilli ekzekutiv i SHP Saraj, nën masa të cilat kanë të

bëjnë me kujdesin nga virusi, më 28 korrik të këtij viti, mbajti seancë në të cilën morën pjesë edhe kryetarët e degëve. Në seancë, krahas tjerave u shqyrtua edhe gjendja në shoqatë, në lidhje me virusin Covid-19. Në këtë kontekst, është konstatuar që të një numër i caktuar i anëtarëve, për shkak të pandemisë është vështirësuar gjendja ekonomike, prandaj KE solli vendim për ndarjen e ndihmës së njëhershme në të holla 30 pensionistëve nga 1800 denarë. Kuptohet që me këtë ndihmë nuk zgjidhen problemet e tyre, por prapëseprapë përfaqëson një ndihmë të vogël. Në seancë u vendos që këtë verë të mos shkohet në det në mënyrë të organizuar, ashti siç

është shkuar më parë, ndërsa nëse anëtarët organizojnë grupe të vogla, shoqata të ju ndihmojë për zgjedhjen e një oferte të pranueshme. Për rreziqet e shkuarjes, shoqata nuk mban përgjegjësi, me çka anëtarëve ju është dërguar letër. Seancë të Këshillit ekzekutiv mbajti edhe SHP Kërçovë nën masa të rrepta mbrojtëse, sipas rekomandimeve të autoriteteve mjekësore dhe LSHPM. Në seancë, në rend dite u vendosën më shumë tema, me të cilat pensionistët janë të brengosur në këto kushte të rënda të pandemisë. Përmes linjës telefonike u soll vendim për ndarjen e ndihmës humanitare 15 pensionistëve me të ardhura më të ulëta, aktivitetet e tilla të vazhdojnë në

bashkëpunim me OO të Kryqit të Kuq, organizatë e cila veçse ka donuar ndihmë banorëve të Shtëpisë së pensionistëve. Gjithashtu, u prezantuan edhe rekomandimet nga ana e LSHPM për qëndrimin në klubin e pensionistëve. Pensionistëve u vije keq që SHP Kërçovë si nikoqir i takimeve rajonale, nuk ishte në mundësi t'i mbajë takimet, për shkak të pandemisë, por për shoqërim ka kohë në kushte më të mira. Përndryshe, pensionistët çdo ditë nga Kërçova vijnë në hapësirat e SHP Kërçovë që të informohen deri ku është porosia e drurit për djegie.


Kuvendi i SHP Gazi Babë më 24 korrik të këtij viti mbajti seancë, në të cilën u miratua raporti i Këshillit ekzekutiv për vitin 2019 në lidhje me vendimin e KE dhe të tjera. Në seancë, njëzëri erdhën në përfundim që SHP Gazi Babë me sukses e ka realizuar Programin e punës për vitin 2019 dhe mjetet janë shpenzuar në pajtim me Planin financiar. Rezultati financiar pozitiv nga puna aktuale e vitit 2019, u vendos në seancë që të vazhdohet në vitin tjetër gjatë punës aktuale.

Senaca dhe aktivitete nën masa mbrojtëse u mbajtën edhe në shoqatat: Qendër, Makedonski brod, Vallandovë, Prilep, Dellçevë etj. nga shkrimet e LSHPM

SEANCA E TRUPIT KOORDINUES TË AKTIVIT TË PENSIONISTEVE

SEANCA E TRUPIT KOORDINUES TË AKTIVIT TË PENSIONISTEVE

Në seancë u parashtruan një numër i madh i pyetjeve, të cilave u përgjigjej kryetarja Trajkova. Gjithashtu, ajo potencoi që shoqatat duhet ta mbështesin dhe nxisin futjen e Kartelës sociale pensionale të gjithë shfrytëzuesve të pensionit, e cila përmban të dhëna për pensionet, moshën, arsimin, pensionistët të cilët jetojnë vetë, për sëmundjet e tyre, afinitetet dhe të tjera.



ju drejtua Marija Monevska, nënkryetare e Trupit koordinues të Aktivit të pensionistëve dhe u dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve, duke theksuar se për shkak të gjendjes me pandeminë të shkaktuar nga Covid-19 aktivitetet e këtij trupi mes dy seancave kryesisht janë realizuar përmes lidhjeve telefonike. Pas miratimit të rendit të ditës, të pranishmëve e ju drejtua kryetarja e Lidhjes, Stanka Trajkova e cila i përshëndeti të gjithë. "E kam nderin dhe kënaqësinë të jem prezente në seancën në të cilën marrin pjesë një numër i madh i kryetarëve të aktivitetit të pensionistëve. Seanca e fundit u mbajt në gusht të vitit 2019 dhe do ishte mirë që së

paku një herë në vit të mblidhemi dhe të shkëmbejmë përvoja për punën e Aktivit të pensionistëve. Për mbajtjen e kësaj seance i siguroam të gjitha kushtet për distancë fizike, si dhe masat tjera mbrojtëse dhe jemi të sigurt që do të ktheheni të shëndoshë. Këtë vit Aktivit i pensionistëve ishin në kulmin e detyrës së tyre përmes aktivitetëve të cilat i morën, ndërsa pjesë e tyre janë të botuara në gazetën "Penzioner plus". Qëllimi i kësaj seance është në mënyrë globale të shqyrtoheni se si funksiononi, cilat janë aktivitetet e juaja dhe me çfarë probleme ballafaqoheni", tha mes të gjithash kryetarja e Lidhjes, Stanka Trajkova. Në diskutimin e saj, nënkrye-

tarja e Trupit koordinues të Aktivëve, Marija Monevska e cila e udhëhoqi mbledhjen tha, "Në këtë mes periudhë aktivitetet e pensionistëve u mblodhën në rajonin lindor dhe rajonin e Vardarit, ndërsa takime do të organizohen edhe në pjesën perëndimore. Takimet u mbajtën në Kavadar, Veles, Makedonska Kamenica, Probishtip... ndërsa u hap edhe faqe në Facebook e quajtur "Rrjeti i Aktivëve të pensionistëve" për të cilën ka interesim të madh".

Në seancë u parashtruan një numër i madh i pyetjeve, të cilave u përgjigjej kryetarja Trajkova. Gjithashtu, ajo potencoi që shoqatat duhet ta mbështesin dhe nxisin futjen e Kartelës sociale pensionale të gjithë shfrytëzuesve të pensionit, e cila përmban të dhëna për pensionet, moshën, arsimin, pensionistët të cilët jetojnë vetë, për sëmundjet e tyre, afinitetet dhe të tjera. Në seancë, kryetarja Trajkova informoi që Lidhja financiarisht i mbështet shoqatat të cilat futin Kartelë sociale pensioniste për dhënien e softuerit, listave anketuese, udhëzime e të tjera. Gjithashtu, u informuan që në Lidhje është formuar Fond i li-

brave dhe kush dëshiron mund të merr libër për periudhë të caktuar ta lexojë dhe ta kthejë. Në fund u sollën edhe disa përfundime, si në vijim. Aktivitetet që zhvillohen në SHP, të vazhdojnë dhe pensionistët ta dëshmojnë që ato janë vepruese të vërteta të aktivitetëve humanitare dhe zëri i aktivistëve të del në sipërfaqe. Të përpilohen Programe për punë për vitin 2021 dhe të njëjtat të parashtrohen deri te Trupi koordinues i Aktivit të pensionistëve në LSHPM, të cilat do të merren parasysh gjatë përgatitjes së Programit të Lidhjes për vitin 2021. Për shkak të punës së suksesshme të Aktivit të pensionistëve rekomandohet në planet financiare të SHP të planifikohen mjete për punën e Aktivit të pensionistëve. Aktivit ta mbështetë dhe ta nxisë futjen e Kartelës sociale pensioniste si dokument i rëndësishëm social për realizimin e punës sociale-humanitare, ashtu edhe për realizimin e aktivitetëve të tjera në shoqatën.

Në debatet morën pjesë pothuajse të gjithë të prezentët, ndërsa nga sukcesi i mbledhjes të gjithë ishin të kënaqur. Marija Monevska.